



Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë

Bachelor

në

"Multimedia dhe Televizion Dixhital"

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Dr. Frida GJERMENI
2. Dr. Fatmira PRODANI
3. MSc. Manjola ZENELI
4. Dr. Spiro PAÇO
5. Oriola DOMI
6. Ergi PANE

Kryetare, Personel akademik DTI
Anëtare, Personel akademik DTI
Anëtare, Personel akademik DTI
Anëtar, Kordinator Institucional
Anëtare, Kordinatore për sigurimin e cilësisë
Anëtar, student në Bachelor në MTVD

Mars / 2023

Lista e Shkurtimeve

LAL	Ligji për Arsimin e Lartë
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MASR	Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
UAMD	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës
PZHS	Plani i Zhvillimit Strategjik
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
RVB	Raporti i Vlerësimit të Brendshëm
NJKTI	Njësia Kryesore e Teknologjisë së Informacionit
NJBTI	Njësia Bazë e Teknologjisë së Informacionit
DTI	Departamenti i Teknologjisë së Informacionit
FTI	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
TI	Teknologji Informacioni
MTVD	Multimedia dhe Televizion Dixhital
NJSBC	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
DMJP	Dega e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve
DKSC	Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
KPGSC	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë
SSC	Sistemi i Sigurimit të Cilësisë



2

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Përshkrim përmbledhës; (200 -400 fjalë)

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës është themeluar në vitin 2006 me Vendimin e Këshillit të Ministrave, Nr. 801, datë 20.12.2005 “Për hapjen e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës” dhe ofron programin e studimit Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhital”. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Teknologjisë së Informacionit që është një nga tre njësitë bazë përbërëse të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. FTI është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr.685, datë 25.08.2010 “Për riorganizimin e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës”, si njësi kryesore brenda strukturës së Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Bachelor në “Multimedia & Televizion Digjital” është një program studimi bashkëkohor dhe shumë i kërkuar që synon të formojë dhe përgatisë specialistë të aftë në fushën e medias dhe televizionit digjital. Qëllimi kryesor i këtij programi është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Fokusi jonë janë studentët e aftësuar në edukim, inovacion, shpirt analitik, zgjidhjen e problemeve të cilat do t'i përdorin gjatë jetës në formimin e karrierës si dhe për të dhënë kontributin e tyre në shoqëri.

Bachelor në MTVD u hap për herë të parë në vitin akademik 2012-2013 me vendim të Ministrisë së Arsimit (*Evidenca 6. Vendimi i hapjes së programit Bachelor në MTVD*). Ky program studimi është realizuar si rezultat i zbatimit të projektit Tempus Ricum të financuar nga Bashkimi Evropian. Ky program studimi u ndërtua fillimisht duke u mbështetur në praktikat më të mira të disa universiteteve evropiane dhe të rajonit.

Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” është përgatitja e specialistëve me formim teknik në fushën e multimedias dhe televizionit digjital. Krahas liberalizimit, rritjes dhe modernizimit të operatorëve radio-televizive, shërbimeve të transmetimit dhe procesit të dixhitalizimit, do të rritet edhe nevoja për specialistë në këtë sektor. Pas realizimit të mbledhjes së të dhënave në tregun e punës në fushën e multimedias dhe televizionit dixhital, është kryer një analizë e detajuar (*Evidenca 11. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin Bachelor në MTVD*) e cila ka ndihmuar në përditësimin të mëtejshëm të kurrikulës Bachelor në MTVD. Këto ndryshime janë realizuar në përputhje me partner Evropian, ekspertë në fushën e multimedias. Ky program studimi inovativ përmbush standardet e BE-së, plotëson nevojat e tregut të punës dhe është harmonizuar me kurrikulën e Masterit Profesional në MDTV.



3

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Për mbarrëvajtjen e procesit të akreditimit të programit të studimit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital", i ofruar në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, Drejtuesi i Njesisë Kryesore të Teknologjisë së Informacionit fillimisht miratoi Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, bazuar në Vendimit Nr. 339, datë 20/01/2023 (*Evidenca 5. Urdhër për ngritjen e grupeve RVB*).

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm përbëhet nga **6 anëtare**, ku njëri është kryetar dhe 5 të tjerët janë anëtarë. Ky grup pune do të jetë përgjegjës për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për programin e studimit Bachelor në MTVD dhe përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm mbështetës. Në grupin e vlerësimit të brendshëm, që operon si grup "ad hoc", është përfshirë edhe një përfaqësues i studentëve që ndjek aktualisht këtë program studimi, që është në proces akreditimi. Çdo anëtar i grupit të vlerësimit të brendshëm është përzgjedhur bazuar në eksperiencën dhe njohuritë që kanë në fushën e multimedias.

Grupi i vlerësimit të brendshëm është i përbërë si më poshtë:

- | | |
|------------------------------|--|
| 1. Dr. Frida Gjermeni | Kryetar (<i>Lektore në Njësinë Bazë së Teknologjisë së Informacionit</i>) |
| 2. Dr. Fatmira Prodani | Anëtare (<i>Lektore në Njësinë Bazë së Teknologjisë së Informacionit</i>) |
| 3. PhD. Cand. Manjola Zeneli | Anëtare (<i>Lektore në Njësinë Bazë së Teknologjisë së Informacionit</i>) |
| 4. Dr. Spiro Paço | Anëtar (<i>Koordinator Institucional i UAMD pranë ASCAL</i>) |
| 5. MSc. Oriola Domi | Anëtar (<i>Kordinatore për sigurimin e cilësisë</i>) |
| 6. Ergi Pane | Anëtar (<i>Student në degën Multimedia dhe Televizion Dixhital</i>) |



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhital”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Të gjitha programet e studimit që ofrohen në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD) janë në përputhje me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare (<i>Evidenca 1. Statuti i UAMD, Neni 58, pika 1</i>). Programi i studimit Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhital” është një program që përputhet dhe mbështetet në interesat kombëtare dhe sidomos ndihmon në zhvillimin më tej të tyre. Misioni i universitetit është të zhvillojë të menduarit kritik e analitik, të kultivojë ndjenjën e përgjegjësisë dhe të angazhimit ndaj njeriut, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin (<i>Evidenca 1. Statuti i UAMD, Neni 3 pika 1</i>). Ky program synon formimin e profesionistëve në fushën e medias dhe televizionit digjital. Këto karakteristika janë në përputhje të plotë me prioritetet kombëtare me “Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026” ku i jepet prioritet programeve të studimit të fushës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, si edhe me “Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022”. Meqenëse ky program studimi është ristrukturuar si rezultat i një projekti Erasmus¹ plotëson edhe prioritetin e BE për procesin e digjitalizimit. Një tjetër synim i këtij programi studimi është që të formojë profesionistë të aftë për të ofruar shërbime në distancë (outsorce) për klientë ndërkombëtarë pa i detyruar studentët të emigrojnë jashtë Shqipërisë por duke i ofruar këtyre të fundit kushtet e duhura të punës në Shqipëri. Në këtë menyrë ky program ndikon në përmirësimin e problemit të emigrimit të të rinjve, duke promovuar aftësitë e tyre profesionale dhe akademike brenda Shqipërisë.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhital” është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës si dhe në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së NJKTI dhe NJBTI. UAMD dhe FTI (<i>Evidenca 1. Statuti UAMD, Neni 3 dhe Neni 4; Evidenca 3. Rregullore e FTI, Neni 1</i>). UAMD dhe FTI synojnë në mënyrë të vazhdueshme të arrijnë standardet akademike më të larta bashkëkohore kombëtare, si dhe të përkrahin aspiratat arsimore dhe arrijtjet e cilit do që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë.

¹ <https://dimtv-project.al/>

Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Ky program studimi formon specialistë dhe profesionistë në fushën e multimedias dhe televizionit dixhital duke ofruar një program studimi që i aftëson studentët për profesionet më të kërkuara nga tregu i punës dhe me një perspektivë në rritje për të ardhmen. Programi i studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” përputhet me qëllimet dhe misionin e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës. Ai ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit (<i>Evidenca 1. Statuti i UAMD; Neni 3 pika 1; Neni 4 pika 1-3</i>). Me misionin e tij universiteti ka për qëllim nxitjen dhe zhvillimin e të menduarit kritik e analitik, si dhe ndjenjës së përgjegjësisë dhe angazhimit ndaj njeriut, komunitetit, kulturave, ngjarjeve e çështjeve të ndryshme që shqetësojnë individin dhe komunitetin. (<i>Evidenca 12. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD për periudhën 2020 – 2025</i>)			
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	NJKTI dhe NJBTI plotësojnë kriteret ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik si dhe të titujve/gradave shkencore. (<i>Evidenca 19. Personeli akademik në FTI</i>). Vlen të theksohet se ky fakultet është hapur në vitin 2010 dhe ka krijuar tashmë një qëndrueshmëri akademike si në numrin e personelit akademik me tituj / grada shkencore por edhe në profilizimin e tyre në kurset përkatëse duke siguruar edhe një cilësi të lartë në mësimdhënie. Personeli akademik i aktivizuar është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike. (<i>Evidenca 20. Personeli akademik i angazhuar në MTVD</i>) Më konkretisht: - 58% e kurseve mbulohen nga personeli akademik i DTI që i kanë mbuluar këto kurse në vazhdimësi ndër vite - 20% e kurseve mbulohen nga personeli akademik i njësive të tjera bazë të FTI (Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe Departamenti i Matematikës) që i kanë mbuluar këto kurse në vazhdimësi ndër vite - 22% e ngarkesës mbulohen nga personeli akademik i njësive të tjera kryesore në UAMD			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Ky program studimi është i fokusuar në fushën e multimedias dhe televizionit dixhital dhe është në përputhje të plotë me fushat akademike dhe kërkimore të NJKTI dhe NJBTI (<i>Evidenca 3. Rregullore FTI, Neni 1 pika b</i>) Përsa i përket kodifikimit të programit të studimit, në pritje të një unifikimi nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, UAMD duke u bazuar në direktivat ndërkombëtare ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve që ofron ku për programin e studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” kodi i përcaktuar është S63BA0619 (<i>Evidenca 17. Kodifikimi i Programeve të studimit UAMD</i>.) Ndërkohë në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ky program studimi është i regjistruar me numër identifikimi DR2136200962. (<i>Evidenca 13. Diploma dhe suplement diplomës</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X






6

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	UAMD ka një strukturë institucionale të konsoliduar ku çdo pozicion pune ka të mirë përcaktuara përkrahjet e punës dhe rregulloret për çdo departament apo sektor. Të gjitha programet e ofruara nga FTI përmbajnë kurse që mbulohen nga të tre departamentet e këtij fakulteti dhe kjo është karakteristikë edhe e programit Bachelor në MTVD. Ky program ka si objektiv aftësimin e studentëve me aftësi në: - Modelim dhe analizim të problemeve, probabilitet dhe statistikë (Departamenti i Matematikës) - Njohuri rreth elektronikës, arkitekturës kompjuterike, audios, përpunimit të zërit, programeve të animimit, transmetimit broadcast dhe TV etj. (Departamenti i Teknologjisë së Informacionit) - Njohuri bazë dhe të avancuara për zhvillimin e programeve në teknologjinë web dhe desktop, bazat e të dhënave etj. (Departamenti i Shkencave Kompjuterike) Pasi FTI harton orarin mësimor për programin e studimit Bachelor në MTVD në koordinim me njësitë bazë të tij, ky orar i dërgohet njësive bazë për të përcaktuar personelin akademik që do mbulojë kurset përkatëse. Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin me korrektësi të detyrave gjatë zhvillimit të mësimin në kursin që mbulon. Ndarjet e përgjegjësisë janë të mirëpërcaktuara në statutin e UAMD, në rregulloren e UAMD si dhe në rregulloren e FTI. (<i>Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 25, pika 8d, Neni 27, pika 3b; Evidenca 3. Rregullore e FTI</i>) Fusha e multimedias është një nga fushat e studimit më bashkëkohorë dhe më e gjithëpërfshirë në teknologjitë e informacionit. Multimedia gjen aplikim jo vetëm në teknologji informacioni por edhe në shkencat kompjuterike, robotikë, bioteknologji, inteligjencë artificiale etj., duke e bërë atë një fushë shumë tërheqëse studimi. Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që plotëson nevojat e tregut të punës dhe synon të nxisë gjithashtu alternativën e vetëpunësimit.
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.	Për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor, zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale etj., FTI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, me biznese të fushës si dhe ka aplikuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që ofrojnë fonde për realizimin e objektivave të mësipërme. UAMD ka mbi 130 marrëveshje bashkëpunimi me universitete homologe të huaja dhe vendase (<i>Evidenca 29. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>).
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Këto marrëveshje përfshijnë edhe pjesën e praktikës mësimore dhe profesionale si në ambjentet e FTI ashtu edhe për praktikat profesionale pranë bizneseve partnere, investimet në infrastrukturë, trajnimin e studentëve dhe personelit akademik, shkëmbimin e studentëve dhe njohjen e krediteve për periudhat e shkëmbimit etj. Për shkak të natyrës së këtij programi studimi dhe të kurseve që përmban, praktikat mësimore zhvillohen kryesisht në ambjentet e FTI falë dhe

 7

Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	investimeve në infrastrukturë që ky fakultet ka bërë për këtë qëllim. (Evidenca 18. Laboratorët e FTL)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	DTI ofron programin e studimit me kohë të plotë Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhital” të organizuar me 180 kredite ECTS me kohëzgjatje normale 3 vite akademik bazuar në Ligj Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 73 pika 1. (Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 43, pika 2.)
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Ndarja e lëndëve në kurrikul është organizuar duke u bazuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 për “elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë. Strategjia e institucionit është të ofrojë programe studimi në përputhje me procesin e Bolonjës në cikle të njëpasnjëshme. Ky program studimi organizohet në module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe Sistemin Amerikan UsCr (Evidenca 2 Rregullore e UAMD, Neni 41 pika 1; Evidenca 1. Statuti i UAMD, Neni 58 pika 1; Evidenca 3. Rregullore e FTL, Neni 30 pika 1).
	Programi përcakton qartë të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore. Në planin mësimor është përcaktuar ndarja e krediteve midis kurseve dhe semestrave, ndarja e veprimtarive formuese dhe pesha e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ndarja e ngarkesës së orëve mësimore në auditor dhe ngarkesa e studimit individual duke ruajtur raportet ku 32% e ngarkesës për çdo kurs zhvillohet në auditor (jo më shumë se 50%). Gjithashtu caktohet edhe ngarkesa e provimit përfundimtar të

8



	diplomimit (6 kredite) dhe që është parashikuar që të jetë 100% studim individual nga ana e studentit. Ndarja e peshës së kategorive për veprimtaritë formuese është në përputhje me kërkesat ligjore për programet e studimit të ciklit të parë (bachelor), përkatësisht: A - Lëndë Bazë - 20% B - Lëndë Karakterizuese - 53.3% C - Lëndë Ndërdisciplinore - 13.3% D - Lëndë Plotësuese - 10% E - Detyrime Përmbyllëse - 3.3% Për të kompletuar elementët që përbëjnë strukturën e programit Bachelor në MTVD, në dokumentacionin shoqërues gjeni edhe programin lëndor dhe formatin e miratuar të diplomës dhe suplementit. (<i>Evidenca 8. Plani mësimor MTVD; Evidenca 14. Diploma dhe suplement i diplomës</i>).
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të parashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Kurset e ofruara në programin e studimit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital" kategorizohen sipas kërkesave ligjore në kurse të formimit bazë, karakterizuese, ndërdisciplinore dhe plotësuese. Ky program studimi synon të formojë dhe përgatisë specialistë në fushën e Teknologjisë së Informacionit të aftë për tregun e punës. Në përfundim të studimeve, lëshohet diploma për programin e studimit që ka kryer (<i>Evidenca 1. Statuti i UAMD, Neni 61 pika 4</i>). Në vitin e parë studentët përfitojnë njohuritë e nevojshme teorike (formim bazë) nga lëndët e përgjithshme. Në vitin e dytë dhe të tretë studentët përfitojnë njohuritë e domosdoshme nga lëndët specifike karakterizuese të fushës profesionale. Grup lëndët karakterizuese që zhvillohen në vitin e dytë dhe të tretë si (Sistemet televizive broadcast, baza animimi, teknologji audio, studio dhe teknologjitë e regjistrimit, produksioni dhe postproduksioni multimedial etj.) zhvillojnë aftësi dhe kompetenca të avancuara në fushën profesionale.
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit nuk përmban ngarkesë në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane, por duhet theksuar fakti që studentët inkurajohen dhe drejtohen të realizojnë praktika profesionale në ambjentet e institucioneve bashkëpunuese në fushën e multimedias. Gjithashtu falë investimit të Komisionit Europian janë ngritur tre laboratore bashkëkohore me qëllim realizimin e praktikave dhe projekteve për çdo lëndë ku nevojitet praktika. (<i>Evidenca 18. Labororet e FTI</i>). Për të ofruar një mjedis mësimor më efektiv dhe për të ndihmuar studentët, në këto laboratore janë siguruar programet e nevojshme (software), për të krijuar hapësirat e përshtatshme mësimore, të shoqëruara me natyrën teknike të këtij programi studimi.
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat	Kjo fushë nuk aplikohet për këtë program studimi pasi UAMD nuk është IAL me status të veçantë.

përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhtal” është ofruar për herë të parë me këtë emërtim në Shqipëri nga FTI pas miratimit me Urdher Hapje Nr.542, Dt. 09/11/2012. Ky program studimi është unik në Shqipëri pasi asnjë institucion i arsimit të lartë nuk ofron program të tillë që përgatit specialist me karakter teknik Staf akademik i Njesisë Bazë të Teknologjisë së Informacionit mbulon kryesisht lëndët me karakter teknik dhe inxhinierik, ndërkohë që për lëndë specifike që kërkojnë njohuri jashtë asaj që mbulon njësia bazë janë shfrytëzuar lektorë me kohë të pjesshme që janë specialist në fusha specifike të multimedias.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Përsa i përket kodifikimit të programit të studimit, në pritje të një unifikimi nga ana e ministrisë përgjegjëse për arsimin, UAMD duke u bazuar në direktivat ndërkombëtare ka hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve që ofron ku për programin e studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhtal” kodi i përcaktuar është S63BA0619 (<i>Evidenca 17. Kodifikimi i Programeve të studimit UAMD,</i>) Ndërkohë në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ky program studimi është i regjistruar me numër identifikimi DR2136200962 (<i>Evidenca 13. Diploma dhe suplementi i diplomës.</i>)			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Kjo fushë nuk aplikohet për këtë program studimi pasi nuk është program i përbashkët studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin Bachelor në “Multimedia & Televizion Dixhtal” është Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI). Kjo njësi ka në strukturën e saj 3 departamente si më poshtë: (<i>Evidenca 3. Rregullore e FTI, Neni 12</i>) 1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI) 2. Departamenti i Shkencave Kompjuterike (DSHK) 3. Departamenti i Matematikës (DM) Përbërja e FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI). Ky departament përbëhet në total nga 13 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë prej të cilëve 1 zotëron gradën

	profesor i asociuar dhe 6 zotërojnë gradën shkencore doktor i shkencave. (<i>Evidenca 19 - Personeli akademik ne FTI</i>) Përbërja e DTI dhe e departamenteve të tjera të FTI është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. NJKTI dhe njësitë bazë nën të përgjegjëse për programet e studimit përmbushin detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike dhe njohin përgjegjësitë e tyre, në mënyrë që të rrisin procesin e mësimdhënies.			
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Në strukturën e FTI aktualisht janë pesë personel ndihmës akademik ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratorit të caktuar. Ky personel ndihmës akademik ka përfunduar studimet në profilin e teknologjisë së informacionit dhe multimedia dhe kanë kualifikimin e duhur dhe aftësitë për të mbuluar detyrimet e tyre për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ofrimin e mbështetjes për personelin akademik për zhvillimin e orëve mësimore apo praktikave profesionale në këto laboratore (<i>Evidenca 21. CV e stafit ndihmes akademik MTVD</i>) Gjithashtu pjesë e FTI janë edhe 5 personel administrativ në ndihmë të programeve mësimore si pjesë e sekretarisë mësimore ku një prej tyre është e dedikuar për programin Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital.			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Me urdher Dekanati të FTI (<i>Evidenca 37. Urdhër Kordinatorët dhe NJSBC</i>) janë përcaktuar Koordinatorët për çdo program studimi të ofruar në FTI. Koordinatori i programit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në UAMD dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve në universitet duke monitoruar dhe analizuar ecurinë e programit të studimit. Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit janë të përcaktuara në Rregullore e programit të studimit si dhe në Rregulloren e Njesisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (<i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit (Bachelor në MTVD Neni 10); Evidenca 36. Rregullore e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të cilësisë (NJSBC), Neni 10</i>). Koordinatori i programit të studimit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital" është Dr. Frida Gjermeni, e cila raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	NJKTI dhe NJBTI përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital", disponojnë të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit (si plani mësimor MTVD së bashku me kurrikulën e programit (<i>Evidenca 8. Planin mësimor MTVD</i>), syllabuse të updatuara të lëndëve të ofruara (<i>Evidenca 9. Syllabuse MTVD</i>), rregullore programi (<i>Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit bachelor MTVD</i>), vendimi i riorganizimit të programit (<i>Evidenca 40. Riorganizimi i programit Bachelor MTVD</i>).

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Plani mësimor i programit Bachelor në “<i>Multimedia dhe Televizion Dixhital</i>” përmban të gjithë elementët e kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Organizimi i këtij programi studimi është bazuar në 3 vite akademike me 180 kredite ECTS dhe përmban 30 javë mësimore në auditor, ku çdo semestër ka 15 javë mësimore në auditor, pra 45 orë (3 orë në auditor çdo javë) dhe 1 orë mësimore është 60 minuta. Bazuar në Planin Mësimor të programit të studimit Bachelor në “<i>Multimedia & Televizion Dixhital</i>”, çdo lëndë është përcaktuar të ketë 6 ECTS dhe lëndët janë të ndara në gjashtë semestra, ku çdo semestër përmban 30 ECTS pra 5 lëndë (4 me detyrim dhe 1 me zgjedhje). Në total programi i studimit ka 30 lëndë, përfshirë këtu edhe provimin/projektin përfundimtar (30 x 6 ECTS = 180 ECTS) bazuar në Ligj Nr. 80/2015 “<i>Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë</i>”, Neni 73 pika 1. (<i>Evidenca 8. Plani mësimor MTVD</i>) Plani Mësimor përmban informacionet e nevojshme për lëndët, për orët që student kalon në auditor dhe orët e punës së pavarur jashtë auditorit. Për sa i përket syllabuseve, studentët informohen nga lektorët e lëndëve përkatëse mbi objektivat dhe qëllimet, temat dhe mënyra e vlerësimit (<i>Evidenca 8. Plani mesimor MTVD</i>). Frekuentimi dhe mënyra e vlerësimit të studentëve është e unifikuar për të gjithë kurset. Frakuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75%. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, i cili konvertohet me notë në proces-verbalin përfundimtar ku nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara (<i>Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 68; Evidenca 3. Rregullore FTI, Neni 52</i>). Vlerësimi bëhet përgjatë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga: 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%)
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Kriteret e pranimit dhe kuotat përcaktohen çdo fillim viti akademik nga NJBTI / NJKTI dhe dërgohen për miratim përfundimtar në Senatin Akademik të UAMD (<i>Evidenca 1. Statuti i UAMD, Neni 62; Evidenca 3. Rregullore e FTI, Neni 33</i>). Përsa i përket transferimeve, studenti duhet të ketë të paktën 30 kredite të njohura nga ana e komisionit ad-hoc (<i>Evidenca 3 – Rregullore e FTI, Neni 39, pika 5; Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 56, pika 4 & 5</i>).
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Çdo lëndë ka programin lëndor sipas formatit të përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi (<i>Evidenca 9. Syllabuse MTVD; Evidenca 8. Plani mesimor MTVD</i>) Ky program lëndor miratohet në departamentin që mbulon lëndën të paktën 10 ditë përpara fillimit të mësimin. Ditën e parë të mësimin, lektori i lëndës duhet të informojë studentët në lidhje me programin lëndor dhe rregullat e vlerësimit (<i>Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 62</i>).
Kriteri 5. Përmbytja e programit të studimit është në përmirësim dhe	Lektori i lëndës ka lirinë akademike për të propozuar në departament ndryshimet në programin lëndor në funksion të përditësimit dhe të përmirësimit të

përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	tematikave me literaturë bashkëkohore për shkak të zhvillimeve të shpejta teknologjike. Këto përmirësime nuk i kalojnë 20% të ndryshimeve të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë. Ky proces, drejtohet nga Koordinator i programit të studimit , çdo fillim semestri dhe ndryshimet e propozuara miratohen në departament përpara fillimit të procesit mësimor për atë semestër. Përgjegjësi i departamentit ruan çdo fillim semestri programet lëndore për të gjithë kurset e ofruara në atë semestër për programin e studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital”. Në kuadër të projektit Erasmus+ “Development and Implementation of Multimedia and Digital TV curricula (DIMTV)” partnerët Europianë kanë dhënë sugjerimet e tyre në lidhje me përmirësimin e syllabuseve të ofruara në programin e studimit Bachelor në MTVD². Te gjitha keto ndryshime u bene efektive ne riorganizimin e programit te studimit ne vitin 2018-2019 (<i>Evidenca 40. Riorganizimi i programit bachelor MTVD</i>).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Lëndët janë të përzgjedhura me kujdes sipas përcaktimeve dhe kriterëve bashkëkohore, si dhe udhëzimeve nga MASH. Përmbajtja e lëndëve përshatet plotësisht me emërtimin e tyre. Përmbajtja e programit të studimit si dhe shpërndarja e zhvillimit të lëndëve realizohet për të arritur aftësimin e studentëve bazuar në nivelin e vështirësisë së lëndëve, ndërlidhjen midis tyre, kërkesat e tregut të punës si dhe kërkesat për vazhdimësinë e studimeve për programet e ciklit të dytë. (<i>Evidenca 9. Syllabuse MTVD</i>)
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Objektivi përfundimtar i këtij programi studimi është që të formojë specialistë të aftë dhe të kërkuar për tregun vendas dhe atë të huaj, në fushën e medias & televizionit dixhital, të aftë në dizejnimin dhe zhvillimin e produksioneve multimediale, sidomos në mediat radio-vizive, me efektivitet dhe interaktivitet, në menaxhimin e sistemeve audio dhe teknologjive mbështetëse. Të gjitha lëndët që përmban kurrikula dhe shpërndarja e tyre janë në funksion të këtij objekti.
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	- Lëndët e vitit të parë ofrojnë përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme, lëndë plotësuese si dhe lëndët bazë karakterizuese si “Bazat e Elektroteknikës”, “Elektroakustike”. Objektivi i vitit të parë është të mundësojë që studenti të integrohet gradualisht me ambientin universitar, metodologjinë e mësimdhënies etj. - Gjatë vitit të dytë studenti frekuenton lëndë karakterizuese profesionale për të përfutur bazat e nevojshme teorike edhe praktike për formimin e tyre profesional. Objektivi i lëndëve të vitit të dytë është që ti ofroje studentëve
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	

² <https://dimtv-project.al/mdtv-bachelor-and-pm-course-syllabuses-review/>

mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	njohuritë karakterizuese e nevojshme profesionale duke i prezantuar ata me sistemet televizive dhe broadcast, dizenjimi grafik, teknologjite audio, bazat e animimit. - Gjatë vitit të tretë studentët frekuentojnë lëndë karakterizuese profesionale të avancuara. Objektivi i lëndëve të vitit të tretë është që të thellojnë njohuritë e përfutuara nga studentët gjatë 2 viteve të para të studimeve duke zhvilluar më tej aftësimin e tyre profesional. Gjatë vitit të tretë studentët përgatiten edhe për përfundimin e studimeve të tyre me anë të një provimi / teme diplome. Përmbajtje e këtij programi studimi është në përputhje me programet e ngjashme në institucionet e tjera të arsimit të lartë në Europë dhe kjo ka mundësuar transferimin e studentëve si dhe mobilitetet e tyre pa hasur në problematika.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.				
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Përditësimi i programit të lëndëve (syllabus dhe material mësimor) realizohet periodikisht duke u bazuar në literaturat apo zhvillimet më të fundit teknologjike. Përgjegjësia për përditësimin e programeve të lëndëve është e personelit akademik që është përgjegjës për ti ofruar ato. Propozimet për ndryshime mund të paraqiten në departament çdo fillim semestri mësimor. Programi Bachelor në “Multimedia dhe televizion dixhital” do t’u shtojë studentëve dijet e nevojshme për të pasur njohuri më të thella dhe të detajuara në fushën e medias dhe produksioneve audio-vizive; specialistë, projektues dhe zbatues të sistemeve dhe produksioneve multimediale, dizajnues grafike, montazhier, Teknik dhe specialiste audio ne ambjentet radiofonike. Kjo është e rëndësishme pasi kontribuojnë direkt në vend, rajon dhe më gjërë.			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Personeli akademik dhe drejtuesit e FTI, në funksion të përmirësimit të programeve mësimore dhe programeve të studimit, janë në komunikim të vazhdueshëm me: - Institucione partnere (IAL) vendase dhe të huaja - Biznese dhe organizata biznesi partnere - Studentë dhe ish studentë të FTI Përmirësimet pasqyrohen si pjesë e: - Përshtatjes së programeve lëndore - Trajnimeve jashtë kurrikulare - Trajnimeve të personelit akademik në fusha specifike - Përmirësimin e infrastrukturës në dispozicion të mësimdhënies dhe praktikave mësimore
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me	


studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	- Zhvillimin e projekteve të përbashkëta apo bashkëpunimeve të ngjashme - Kur është e nevojshme edhe në ndryshime në kurrikulën e programit të studimit Këto ndryshime reflektohen pasi miratohen nga organet drejtuese përgjegjëse në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Në programin e studimit Bachelor në <i>"Multimedia dhe Televizion Dixhital"</i> mësimi zhvillohet si ndërthurje e elementëve të mëposhtëm: a) leksione; b) seminarat; c) orë të integruara të leksioneve me seminarat; ç) ushtrime; d) laborator; dh) projekte/detyra kursi individuale dhe/ose në grup; e) provime të ndërmjetme dhe provime përfundimtare; ë) në formën e praktikës profesionale të zhvilluar në laboratore të FTI-së, dhe/ose në institucione dhe kompani me të cilat FTI / UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi; f) konsultime individuale ose në grupe me pak studentë; (<i>Evidenca 3. Rregullore FTI, Neni 43, pika 3; Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 60, pika 5</i>).
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin	

 15

 Elane

e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Është e drejta e personelit akademik të lëndës për të kombinuar këto elementë për të arritur objektivat e përcaktuar në programin e lëndës si dhe për tu përshtatur me kërkesat e studentëve dhe nevojat e tyre.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Nga investimet e përfuara nga projektet kombëtare dhe ndërkombëtare, FTI ofron për studentet e programit të studimit Bachelor në <i>"Multimedia dhe Televizion Dixhital"</i> dhe për anëtarët e personelit akademik kushtet optimale për të punuar dhe për të praktikuar të gjithë elementët e mësipërm të mësimin si dhe për të eksperimentuar metoda alternative të mësimdhënies. <i>(Evidenca 18. Laboratorët FTI)</i> Auditorët në dispozicion të këtij programi janë të hapur për studentët edhe jashtë orarit mësimor dhe ofrojnë kushtet teknike dhe programet e nevojshme për praktikën e tyre dhe zhvillimin e projekteve të ndryshme. Personeli akademik mund të përdori teknologjitë audio / video, PC dhe internet të dedikuar për zhvillimin e procesit mësimor dhe praktikës mësimore. Çdo kërkesë e personelit akademik / studentëve për kushtet e mësimin merret në konsideratë dhe aplikohet në afate të shkurta kur konsiderohet e përshtatshme.³ UAMD praktikon një formë të re interaktive dhe inovatore të gërshetimit të orëve të leksionit me seminarin, që nxit debatin pedagog – student. UAMD ofron njësi infrastrukture që rrisin inovacionin e mësimdhënies si: Laboratori i Multimedias dhe studio audio-vizive. <i>(Evidenca 18. Laboratorët FTI)</i> Format kryesore të procesit mësimor në programin e studimit MP në "Multimedia dhe Televizion Dixhital" janë leksionet e integruara me shembuj praktikë dhe projektet e realizuara nga studentët. Lektorët për të siguruar mësimdhënie cilësore përdorin metoda bashkëkohore bazuar në eksperiencën e universiteteve homologe të vendeve të zhvilluara të BE. Gjithashtu, metodat e mësimdhënies janë të bazuara në eksperiencat shumë vjeçare të partnerëve të huaj me të cilët kemi bashkëpunim institucional. Tashmë prezantimet bëhen me kompjuter/laptop dhe projektor, ku paraqiten jo vetëm leksionet në powerpoint, por edhe me video apo ilustrime të tjera sipas nevojës. Studenti është në qendër të vëmendjes dhe orët e mësimin në janë interaktive duke u realizuar edhe në formën e diskutimit.
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka një eksperiencë të gjatë akademike si personel akademik me kohë të plotë pranë UAMD. 80% e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë të punësuar me kohë të plotë në UAMD dhe kanë një eksperiencë disa vjeçare në këtë profesion. <i>(Evidenca 19. Personeli akademik në FTI; Evidenca 24. Analiza vjetore e DTI)</i> Lëndët kanë në programin e tyre edhe një projekt individual ose në grup që zhvillohet përgjatë kohëzgjatjes së semestrit nën mbikëqyrjen e personelit akademik të lëndës duke inkurajuar punën në grup midis studentëve, të menduarit kritik si dhe bashkëpunimin lektor-student.

³ <https://www.facebook.com/FTIUAMD/videos/962086334143917/>



Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës sigurimi i cilësisë është një prioritet. Si pjesë e aktiviteteve në këtë kuadër hartohet edhe një raport vetëvlerësimi periodik (<i>Evidenca 38. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë</i>) për monitorimin e: 1. Organizimit dhe Menaxhimit 2. Burimeve 3. Kurrikulave 4. Mësimdhënies, Mësimnxënies, Vlerësimit dhe Kërkimit 5. Studentëve dhe Mbështetjen e tyre Qëllimi i këtij vlerësimi është inkurajimi i IAL-së që të punojnë për rritjen e vazhdueshme dhe sistematike të cilësisë së ofertës akademike dhe përmirësimin e kushteve të mësimdhënies dhe mësimnxënies të studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyra e vlerësimit të studentëve është e përcaktuar qartë në rregulloret e institucionit dhe rregulloren FTI, (<i>Evidenca 2 - Rregullore e UAMD Neni 68; Evidenca 3 - Rregullore e FTI, Neni 52</i>), e unifikuar për të gjitha lëndët e programit të studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Digital”. Vlerësimi bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga: I. Provimi i ndërmjetëm (40%) II. Provimi përfundimtar (50%) III. Projektet / detyrat e kursit (10%)
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Provimi i ndërmjetëm realizohet në mes të semestrit (java 7/8) kurse provimi përfundimtar në përfundim të semestrit (java 16/17). Në rast se studenti nuk arrin të fitojë pikët e nevojshme për të kaluar lëndën atëherë ai mund të zgjedhë ta rifrekuentoje këtë lëndë në vitin pasardhës ose ta regjistrojë për riprovim (testim unik me 1000 pikë) në sezonet përkatëse (dimër, verë, vjeshtë). Vlerësimi bazuar në pikët e përftuara është: Nota 4: 0 – 504 pikë; nota 5: 505-574 pikë; nota 6: 575-664 pikë; nota 7: 665-754 pikë; nota 8: 755-844 pikë; nota 9: 845-934 pikë; nota 10: 935-1000 pikë.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e	Studentët informohen mbi përmbajtjen e syllabusit të çdo lënde që në orën e parë të mësimi. Kjo është një praktikë e konsoliduar në UAMD dhe e përcaktuar si

vlerësimi të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	detyrim për tu realizuar nga lektori i lëndës edhe në rregulloren e institucionit (<i>Evidenca 2. Rregullore UAMD, neni 62, pika 3</i>). Çdo syllabus është i ndërtuar bazuar në legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e MASR dhe përgjithsisht përmbajnë të gjitha elementet informuese për studentin. Të gjitha këto elemente e njohin studentin me titullarin e lëndës, metodologjitë e mësimdhënies dhe mësimnxënjes si edhe me metodat e vlerësimit (<i>Evidenca 2 – Rregullore UAMD, Neni 52, pika 6</i>). Gjithashtu gjatë javës së parë të mësimi FTI organizon javën e orientimit për të informuar studentët e viteve të para në lidhje me rregullat e vlerësimit dhe jo vetëm.			
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Studentët kanë mundësi të shprehin opinionin e tyre duke komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me personelin akademik të lëndës, koordinatorin e programit të studimit ose me drejtuesit e FTI ose duke plotësuar anketimin në përfundim të kursit që organizohet në nivel institucional. Personeli akademik informohet në mënyrë periodike në lidhje me opinionin e studentëve në përfundim të çdo semestri për seksionet që ai mbulon. Ai ka autonomi të plotë për përzgjedhjen e mënyrës dhe metodave të mësimdhënies që mendon si më të përshtatshme për të arritur objektivat e synuara nga lënda që ofron.			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Si pjesë e vlerësimit në çdo lëndë është edhe projekti i kursit i cili synon të nxisë punën e pavarur të studentëve, bashkëpunimin në grup si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit midis tyre. Personeli akademik, nëse e gjykon të arsyeshme, mund të përshtasë lehtësisht metodat e mësimdhënies gjatë kohëzgjatjes së semestrit ose për seksionet pasardhëse duke u përshtatur me kërkesat specifike të kursit dhe studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Forma e vetme e kontrollit të dijes në Universitetin "Aleksandër Moisiu" është provimi me shkrim. 40% e vlerësimit të studentëve realizohet me testimin e ndërmjetëm që zhvillohet në mes të ngarkesës mësimore të lëndës dhe 50% e vlerësimit bazohet në provimin përfundimtar në përfundim të lëndës. Përgjatë zhvillimit të mësimi studenti përgatit edhe detyrat/projektin e kursit që u përcaktohet nga personeli akademik në fillim të procesit mësimor. Ky projekt mbrohet në javën e fundit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar. (<i>Evidenca 2- Rregullore UAMD, Neni 62, pika 3</i>).

18



Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mënyra e vlerësimit është e pasqyruar në syllabus-in e çdo kursi në përputhje me përcaktimet e akteve rregullatore të FTI / UAMD.
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	UAMD ka një marrëveshje bashkëpunimi si pjesë e projektit Clean Score të mbështetur nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim.⁴ Çdo personel akademik i FTI që ka dëshirë të realizojë vlerësimin elektronik të provimeve e ka mundësinë për ta aplikuar këtë metodë si pjesë e këtij bashkëpunimi. Për shkak të karakteristikave të lëndëve që ofrohen në këtë program studimi, zbatimi i teknologjisë në testimin dhe vlerësimin studentëve konsiderohet i papërshtatshëm. Kjo për shkak se përdorimi i këtyre teknologjive kufizon lektorin në ndërtimin e tezës (vetëm alternativa) si dhe kufizon edhe vlerësimin e metodologjisë së zgjidhjes së ushtrimeve. Pas përfundimit të provimit, studentët njihen me çelësin e tezës dhe lektori u cakton një seancë ku i njeh ata me vlerësimin përfundimtar
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	FTI garanton të drejtën e çdo studenti për t'u njohur me vlerësimin si dhe për të marrë një informacion të detajuar nga lektori i kursit në lidhje me mënyrën e vlerësimit së bashku me identifikimin e gabimeve që studenti ka bërë në testim. Për çdo provim, lektori i kursit informon studentët për ditën, sallën dhe orarin kur studentët mund të bëjnë ballafaqimin e rezultateve të provimit. Pasi ka bërë ballafaqimin e rezultateve me studentët, lektori duhet të dorëzojë pranë sekretarisë mësimore procesverbalin e rezultateve përfundimtare (dhe në sistem) së bashku me provimet jo më vonë se 72 orë nga dita e zhvillimit të provimit (<i>Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 69, pika 7; Neni 72, pika 3i</i>).
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Në rast se studenti, edhe pas ballafaqimit të rezultateve me stafin akademik, nuk është i bindur për saktësinë e vlerësimit atëhere ai ka të drejtë që brenda afateve të parashikuara në rregullore të paraqesë në dekanat një kërkesë me shkrim për rishikim të vlerësimit të provimit. Në rastet kur kërkesa miratohet atëhere departamenti ngre një komisioni ad-hoc vlerësimi jo më vonë se 3 ditë nga miratimi i kërkesës, të përbërë nga lektor të asaj disipline. Lektori i seksionit nuk mund të jetë anëtar i komisionit të rishikimit. Komisioni përcakton ditën dhe orën e rishikimit duke informuar studentin dhe lektorin e seksionit dhe bën rivlerësimin e tezës në prezencën e tyre. Komisioni del me një vendim për rezultatin e vlerësimit (<i>Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 71</i>).
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E gjithë procedura ruhet në protokollin e FTI.
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra	Plagjiatura dhe kopjimi janë të ndaluara për studentët (<i>Evidenca 2 - Rregullore UAMD, Neni 116, pika e</i>). Në rast se studenti thyen rregullat e provimit, studenti ndërpret provimin dhe plotësohet procesverbali për parregullsi në provime nga personeli akademik i kursit dhe asistuesi përkatës. Gjithashtu procesverbalit i bashkëngjitet provimit i cili vlerësohet me 0 pikë (<i>Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 70, pikat 3-7</i>).

⁴ <https://cleanscore.al/arkiva/794>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në <i>"Multimedia dhe Televizion Dixhital"</i> synon thellimin e njohurive teorike dhe zhvillimin e aftësive praktike profesionale në fushën e mediumeve audio-vizive. Të gjithë lëndët e këtij programi janë në funksion të përmbushjes së këtyre objektivave.
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Ky program studimi është plotësisht i fokusuar në zhvillimin e njohurive në fushën e multimedias, kanaeve televizive dhe radiofonike. Çdo student që përfundon programin e studimit Bachelor në <i>"Multimedia dhe Televizion Dixhital"</i> është i aftë për të qenë konkurrenës në tregun e punës. (<i>Evidenca 10 – Rregullore e programit të studimit (Bachelor në MTVD, Neni 6)</i>)
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Në javën që i paraprën provimit, programi i lëndës parashikon orën e përsërtjes së programit mësimor të trajtuar gjatë zhvillimit të lëndës (<i>Evidenca 9. Syllabuset e programit të Studimit Bachelor MTVD</i>). Personeli akademik i lëndës udhëzon studentët në lidhje me provimin përfundimtar si dhe i përgjigjet pyetjeve të tyre në lidhje me paqartësitë që ata mund të kenë në lidhje me tematika të caktuara. Në këtë javë realizohet edhe mbrojtja e detyrave / projekteve të kursit. Cilësia e këtyre detyrave / projekteve duhet të pasqyrojë edhe kompetencat që studentët kanë përfutur gjatë zhvillimit të lëndës. Midis të tjerash, këto detyra / projekte kanë si qëllim nxitjen e punës në grup midis studentëve dhe të diskutimeve konstruktive ndërmjet tyre. Këto detyra / projekte bazohen në zgjidhjen e problematikave / çështjeve të caktuara që miratohen nga personeli akademik i lëndës në javët e para të mësimin. Në rastet kur këto projekte pasqyrojnë cilësi të lartë kërkimore ose ide inovative, personeli akademik inkurajon studentët për të prezantuar punën e tyre në aktivitetet e organizuara nga FTI si konferenca, workshops etj. (<i>Evidenca 33. Workshop-e Studentore (FTI)</i>). Këto aktivitete promovojnë punët e studentëve dhe mbështeten financiarisht nga UAMD dhe nga biznese partnere. Pjesëmarrja e studentëve në këto aktivitete është pa pagesë (si psh në konferenca shkencore ndërkombëtare të organizuara nga FTI ⁵) dhe kur është e mundur ata përfitojnë edhe çmime apo dhurata për pjesëmarrjen e tyre në këto aktivitete. Bazuar në rezultatet e provimit si dhe cilësinë e detyrave / projekteve të kursit, stafi akademik i lëndës planifikon përshtatjet e nevojshme për vitin e ardhshëm akademik. Përgjatë vitit akademik, FTI organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime, orë informuese etj. për studentët e saj. Këto orë mund të drejtohen nga personeli akademik i FTI (i brendshëm ose i ftuar), përfaqësues biznesesh, ekspertë të ndryshëm etj. Këto aktivitete realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikant profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe	

⁵ <https://icita.epoka.edu.al/2018/>

teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Aktivitetet që kanë lidhje me programin Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” janë trajnime, leksione të hapura, orë informuese për mundësi punësimi apo mundësi trajnimesh jashtë UAMD etj.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	1. Në përfundim të programit të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës. 2. Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze/projekti diplome ose me provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi. Për të marrë pjesë në provimin / tezën e diplomës studenti duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet e tjera të kurrikulës. Ai mund të regjistrohet vetëm pasi shlyerja e këtyre detyrimeve konfirmohet nga sekretaria e NJKTI-së. Procedura e organizimit dhe e vlerësimit të provimit të diplomës pasqyrohet në rregulloren e FTI (<i>Evidenca 3. Rregullore FTI, Neni 59-62; Evidenca 2 - Rregullore e UAMD, Neni 76-79</i>).
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të vitit akademik, DTI u bën të njohur studentëve të programit të studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” pyetjet e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit. Studentëve u ofrohet edhe një bazë pyetjesh orientuese për të studiuar. Përgjatë vitit akademik studentët mund të konsultohen me lektorët përkatës në lidhje me pyetjet e provimit të diplomimit sipas orareve të konsultimit të ofruara nga lektorët. (<i>Evidenca 3. Rregullore FTI, Neni 62, pika 3</i>). Për studentët që zgjedhin të zhvillojnë temë diplome, dekanati i FTI përcakton një lektor udhëheqës bazuar në kërkesën e studentit dhe propozimin e DTI. Tezat e diplomës për programet e studimit bachelor udhëhiqen vetëm nga personeli akademik me kohë të plotë i FTI. (<i>Evidenca 3. Rregullore FTI, Neni 60, pika 3</i>).
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Teza e provimit të diplomimit për programin e studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” bazohet në 5-6 kurse / module bazë të programit të studimit të cilat përcaktohen çdo vit me propozim nga NJBTI dhe me vendim dekanati. (<i>Evidenca 3 - Rregullore e FTI, Neni 62, pika 2</i>) Mbi bazën e këtyre kurseve ndërtohet baza e pyetjeve orientuese që u ofrohet studentëve në fillim të semestrit të dytë.
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe	Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga dita e fillimit të vitit akademik, DTI u bën të njohur studentëve të vitit të fundit të programit të studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Digjital” programet e provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomimit. Gjithashtu studentëve u ofrohet edhe një bazë pyetjesh orientuese për të studiuar sipas lëndëve të përcaktuara nga DTI (<i>Evidenca 3 - Rregullore FTI, Neni 62, pika 3</i>).

miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Gjatë gjithë vitit akademik, personeli akademik me kohë të plotë ofron për studentët 5 orë konsultimi në javë për t'i orientuar ata për çdo paqartësi që mund të kenë në lidhje me lëndët përkatëse Teza e diplomës është punim individual i studentit. Ajo nuk mund të mbrohet përpara komisionit nëse më parë nuk është dhënë miratimi me shkrim i personelit akademik udhëheqës. Studenti duhet të dorëzojë në departament punimin përfundimtar në tre kopje së bashku me miratimin e personelit akademik udhëheqës të paktën 2 javë përpara datës së shpallur për mbrojtjen e temës. <i>(Evidenca 3 - Rregullore FTI, Neni 60, pika 6 dhe 7)</i> Personeli akademik udhëheqës ruan kontakt të vazhdueshëm me studentin, e orienton dhe asiston atë gjatë zhvillimit të punimit dhe është përgjegjës për miratimin e këtij punimi.			
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Ambjentet e FTI, laboratorët mësimore dhe kërkimorë, biblioteka etj. janë në dispozicion të studentëve edhe jashtë orareve mësimore kur këta të fundit kërkojnë t'i përdorin këto ambiente për kryerjen e praktikave të tyre mësimore, zhvillimin e projekteve mësimore ose dhe projekteve kërkimore.			
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi I diplomimit ose tema e diplomës për programin e studimit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital" ka një peshë prej 6 kreditesh dhe vlerësohet me notë bazuar në pikët e përfutuara nga studenti dhe me të njëjtën shkallë vlerësimi si lëndët e tjera të këtij programi <i>(Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 68 pika 8)</i>. Mënyra e vlerësimit përcaktohet në rregulloren e FTI <i>(Evidenca 3. Rregullore FTI, Nenet 61-62)</i>.			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studentët e programit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Digjital" pajisen me diplomën e miratuar me Urdhën nr.341, datë 22/10/2020 të QSHA si dhe suplementin përkatës të diplomës. Procedurat e lëshimit të diplomës përcaktohen në rregulloret e institucionit. <i>(Evidenca 13. Diploma dhe suplementi i diplomës Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 76 dhe Neni 90)</i> Suplementi i diplomës përmban të gjithë elementët e programit të studimit. Ky dokument ofrohet në shqip dhe në anglisht.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Në çdo kohë studentët dhe ish studentët e FTI mund të kërkojnë pranë sekretarisë mësimore të FTI vërtetime të thjeshta dhe listë notash të programit të studimit që ndjekin ose kanë përfunduar. Me kërkesë të tyre ata mund të pajisen edhe me programin lëndor për çdo kurs që ata kanë zhvilluar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

 22



IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Duhet theksuar se pjesë me e madhe e personelit akademik që është angazhuar në mësimdhënie në lëndët e programit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhtal" është i punësuar me kohë të plotë pranë UAMD. <i>(Evidenca 24. Analiza Vjetore DTI)</i>. Të gjithë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë të kategorive profesor, lektor dhe asistent lektor duke përmbushur kërkesën ligjore që personeli akademik i angazhuar duhet të ketë një nivel kualifikimi më të lartë se cikli i studimeve ku angazhohen në mësimdhënie. <i>(Evidenca 19. Personeli akademik në FTI)</i> Kualifikimi profesional dhe fusha akademike e personelit akademik të angazhuar në programin Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhtal" është në përputhje me kurset ku ata janë aktivizuar. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një angazhim disavjeçar në kurset përkatëse.
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Ngarkesa mësimore e personelit akademik është gjithmonë me përputhje me kornizën ligjore në fuqi. <i>(Evidenca 24 - Analiza Vjetore DTI)</i> . Kjo ngarkesë miratohet çdo semestër nga DTI / FTI si dhe monitorohet nga rektorati dhe zyrat përkatëse për t'u siguruar që orët vjetore në auditor si dhe numri i lëndëve për çdo semestër të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet cilësore të UAMD.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Personeli akademik me kohë të plotë i DTI / FTI ka lidhur një kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor dhe me afat të pacaktuar për kategoritë lektor dhe profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Edhe në rastet e kontratave me kohë të caktuar <i>(Evidencë 27. Model Kontratë Pune)</i>, rinovimi i tyre bëhet automatikisht bazuar në rekomandimin e përgjegjësit të DTI dhe Dekanit të FTI në rastet kur performanca e personelit akademik është në nivelin e kërkuar. UAMD siguron mbulimin me korrektësi të të gjitha detyrimeve financiare duke përfshirë edhe mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. <i>(Evidenca 16. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike (DBNjJ))</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Rekrutimi i personelit akademik pranë FTI zhvillohet në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe sipas procedurave të pasqyruara në rregulloret e UAMD <i>(Evidenca 2. Rregullore UAMD, Nenet 103-106)</i> FTI / UAMD shpall konkursin për vende të lira pune, sipas strukturës së përgjithshme në nivel institucional, të miratuar nga Bordi Administrimit dhe kryen publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shkruar dhe elektronike. Gjithashtu njoftimet publikohen dhe në faqen zyrtare të UAMD së bashku me formularët e aplikimit. Vetëm dosjet e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe protokollohen, sipas rregullave në fuqi.

	Drejtuesi i njësisë kryesore krijon komisionin <i>ad-hoc</i> për përzgjedhjen e kandidatëve fitues sipas përcaktimeve në aktet ligjore në fuqi dhe Statutit të UAMD-se. Komisioni bën vlerësimin e kandidaturave në dy faza, që janë vlerësimi i dosjes dhe intervista. Vetëm kandidatët e kualifikuar nga faza e shqyrtimit të dosjeve i nënshtrohen intervistës. Vlerësimi i kandidaturave për personel akademik bazohet në: I. Vlerësimi i dosjes përmban 70% të vlerësimit; II. Intervista e cila përmban 30% të vlerësimit; <i>(Evidenca 1. Statuti Uamd, Neni 45; Evidenca 2. Rregullore UAMD, Neni 103)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në strukturën e FTI aktualisht janë gjashtë personel ndihmës akademik ku secili prej tyre është përgjegjës për mirëmbajtjen e një laboratorit të caktuar. Ky personel ndihmës akademik ka përfunduar studimet në profilet e teknologjisë së informacionit dhe kanë kualifikimin e duhur dhe aftësitë për të mbuluar detyrimet e tyre për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe ofrimin e mbështetjes për personelin akademik për zhvillimin e orëve mësimore apo praktikave profesionale në këto laboratore. <i>(Evidencë 21. CV e stafit akademik të MTVD)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Si pjesë e detyrimeve për raportimet periodike, DTI / FTI çdo vit akademik dorëzon pranë rektoratit të dhënat për angazhimin e personelit akademik të detajuar sipas kurseve, semestrit dhe programit të studimit. Këto të dhëna administrohen nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë për monitorimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e njesive bazë dhe kryesore të UAMD.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Kurset e fokusuara në aspektin praktik e zhvillojnë mësimin e tyre në laboratorët që FTI disponon falë bashkëpunimit me bizneset partnere ose përfitim të investimeve nga projekte kombëtare ose ndërkombëtare. Struktura e personelit akademik të FTI-së është e përbërë nga 43 anëtarë me kohë të plotë, 13 prej të cilëve janë pjesë e DTI. I gjithë personeli akademik me kohë të plotë i DTI është i angazhuar në udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve për punimin e diplomës si dhe në çdo veprimtari tjetër përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre.
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që	

24



angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Ky kriter nuk aplikohet për programin e studimit Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital" pasi në kurrikulën e këtij programi studimi nuk parashikohet zhvillimi i praktikës profesionale. Në rastet kur ky aktivitet zhvillohet si aktivitet shtesë (jashtë kurrikulës) me kërkesë të studentit ose bizneseve partnere, atëherë këta të fundit krijojnë kushtet e duhura për të ndihmuar studentët në aftësimin e tyre të mëtejshëm profesional gjatë zhvillimit të praktikës				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht		Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
					X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Aktualisht FTI zotëron 3 laboratorë programimi (sallat 101, 111 dhe 211) të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikatat mësimore për lëndë të këtij profili, 3 laboratorë të profilit të multimedias (sallat 103 dhe 203), një laborator kërkimor (salla 015) dhe VTech Hub (401). Këta laboratorë kanë lidhje interneti, 20-30 PC me parametra të përshtatshëm dhe të kompletuar me programet e nevojshme për të zhvilluar procesin mësimor dhe praktikatat profesionale, LED screen 65" ose projektorë HD për zhvillimin e procesit mësimor në kushte optimale, kamera survejimi, një laborant të dedikuar vetëm për mirëmbajtjen teknike të këtij laboratorit dhe për atë asistuar stafin akademik që zhvillon zprocesin mësimor dhe praktikatat në këtë laborator, sistem kondicionimi, kapacitet për zhvillim leksionesh për 40- 60 studentë, lap top për stafin akademik që zhvillon aktivitetin mësimor në këtë laborator. (<i>Evidenca 18 - Labororet FTI</i>) Të gjitha lëndët që synojnë aftësimin profesional dhe praktik të studentëve zhvillohen në laborator duke shfrytëzuar pajisjet dhe programet e specifike për realizimin e objektivave të kursit përmes përdorimit të teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Për zhvillimin e leksioneve dhe lëndëve teorike përdoren sallat e tjera (104, 105, 107, 108, 110, 210, 220 me kapacitet total 420 vende) që janë në funksion të NJKTI të cilat janë të pajisura me sistem kondicionimi ngrohje/frohje, ndriçim, hapsira të mjaftueshme mëse komde për numrin e studentëve dhe në rastet e nevojshme, mësimi zhvillohet me video-projektor.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale	

25

sipas natyrës së programit të studimit që ofron.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	E gjithë literatura e detyruar e kurseve ofrohet në gjuhën e programit të studimit (shqip) kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara për këtë program studimi.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Pasqyrimi i përditësimit të literaturës së detyrueshme bëhet në departament pasi ky i fundit miraton këtë literaturë. Pas miratimit, ndryshimet pasqyrohen edhe në syllabusin e kursit. Pasqyrimi i përditësimit të literaturës së rekomanduar pasqyrohet në syllabus nga personeli akademik përgjegjës për lëndën dhe miratohet çdo fillim semestri në departament.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në mjediset e UAMD (Godina nr.1, Currila) ndodhet Biblioteka, e cila arkivon dhe mirëmban pasurinë akademike, kulturore e shkencore të Institucionit. Ajo është në shërbim të plotë të studenteve, pedagogëve, e studiuesve. Ajo funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 8576, datë 3.2.2000, Neni 30, "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë". Ajo kryen dixhitalizimin e skedarëve dhe ka në fondin e saj rreth 12000 tituj në gjuhën shqipe dhe të huaj, në formatin letër dhe elektronik. Gjithashtu, ofron mundësi kërkimi të informacionit on-line, në sallën e leximit, mundësi shfletimi të literaturës elektronike, pranë kompjuterave të sallës, si edhe lehtësi në kërkimin bibliografik të informacionit. Të gjitha informacionet në lidhje me Bibliotekën mund të aksesohen edhe nëpërmjet hapësirës Web në faqen zyrtare të UAMD. ⁶ (<i>Evidenca 35- Rregullorja e Bibliotekës</i>)

⁶ <https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/>

26



Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka universitare garanton literaturë kryesisht të viteve të fundit, tekste mësimore dhe plotësuese, në përputhje me kurrikulat mësimore. Numri i kopjeve për çdo titull varion nga 2-5 kopje mesatarisht, ndërsa kopjet e librit të huaj variojnë nga 1 - 2 kopje. Krahës librit fizik, ekziston edhe libri elektronik, (mbi 10000 tituj). Megjithatë, literatura nuk është e mjaftueshme në sasi, në raport me numrin e përdoruesve. Biblioteka universitare është hibride dhe me fonde të hapura. Aktualisht në UAMD janë funksionale 3 biblioteka. Koleksioni i tyre përfshin burime që plotësojnë nevojat e të gjithë përdoruesve të saj si nga përmbajtja ashtu dhe nga forma. Pasurimi i koleksioneve në përputhje me kurrikulat mësimore është i vazhdueshëm, por jo periodik, në varësi të mundësive buxhetore dhe kryhet nëpërmjet: blerjeve, dhurimeve, shkëmbimit të materialeve mes bibliotekave, artikujve shkencorë, tezave dhe dizertacioneve. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore. Biblioteka posedon një literaturë shumëdisiplinore, duke mbështetur kurrikulat e të gjithë fakulteteve të universitetit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Çdo student/ pedagog ka të drejtën e anëtarësimit falas në bibliotekë. Studenti disponon një kartelë regjistrimi me të dhënat personale dhe pajiset me librezë anëtarësie. Ai ka të drejtë të përdorë kompjuterat e sallave, për navigimin në burimet elektronike, ose përdorimin e katalogut elektronik. <i>(Evidenca 35- Rregullorja e Bibliotekës)</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Ambjentet e bibliotekës ofrojnë PC, ku kanë të instaluar programe të përshtatshme sipas profilit të studimit duke ju mundësuar studentëve leximin dhe studimin dhe realizimin e detyrave. Për më tepër në kuadër të projekteve Erasmus+, programit të studimit MTVD janë shtuar dhe rreth 60 libra në gjuhën angleze që mbulojnë njohuritë në fushën e animimit 3D, realiteti virtual dhe produksion postproduksion.			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka e UAMD funksionon në orarin 8.00-16.00 nga e hëna në të dielë. Orari i punës në bibliotekë shpallet në mjediset e institucionit dhe në Web-in e universitetit.			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 4 dhe nenit 7, Kreu I, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë.29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, biblioteka në bashkëpunim me fakultetet dorëzon prane drejtorise se menaxhimit financiar kërkesat për blerje libri, materiale, pajisje, rafte, skanera, kompjutera, etj. Çdo vit akademik parashikohen fonde për blerjen e literaturës shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

27



Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Institucioni administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. Pasi kandidati fiton statusin e studentit, regjistrohet në sekretarinë mësimore të fakultetit duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm si edhe duke respektuar afatet e përcaktuara nga MASR. Mbështetur në legjislacionin në fuqi dokumentacioni themelor për studentët është: • Regjistri themeltar i studentit i cili vërteton regjistrimin e studentit që pajiset me numër matriculimi deri në marrjen e diplomë ose certifikatës. • Regjistri i arritjeve akademike të studentit që vërteton rezultatet e studentit gjatë aktivitetit të tij akademik. • Regjistri i lëshimit të diplomave dhe certifikatave që vërteton emetimin e certifikatave dhe diplomave. (Evidenca 2. Rregullore e UAMD, Neni 89). Aktualisht në funksion të FTI dhe të programit të studimit Bachelor në MTVD është sistemi Pitagora i cili administron të dhënat e studentëve dhe i ofron atyre një hapësirë vetjake për të aksesuar notat, ndërtuar orarin, regjistruar modulet, riprovimet etj. Ky system ofrohet në bashkëpunim me RASH. Për t'i ardhur në ndihmë studentëve në përdorimin e këtij sistemi, në faqen Web të UAMD⁷ gjendet edhe një udhëzues përdorimi.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Çdo përdorues për sistemin Pitagora ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në FTI/UAMD: - Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. - Personeli akademik ka akses te regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. - Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. - Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit dhe pagesave të kryera Këto të dhëna janë të kufizuara vetëm brenda aktivitetit që përdoruesit zhvillojnë në UAMD duke ruajtur konfidencialitetin e çdo studenti ose anëtar të personelit të FTI. Të dhënat janë të ruajtura për të gjitha vitet që përdoruesi është pjesë e FTI.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme,	Faqja zyrtare e UAMD është https://uamd.edu.al, ku përtej çdo informacioni të mundshëm në lidhje me institucionin, kemi dhe informacion të detajuar në lidhje

⁷ <https://uamd.edu.al/pitagora/>

publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet përkatëse në seksionin e dedikuar për Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit⁸ 1. Nën menunë e Njesisë Bazë gjendet informacion i detajuar në shqip dhe anglisht mbi personelin akademik, misionin dhe vizionin, kurrikula, dhe syllabuset përkatëse si dhe kriteret e aplikimit për tek programi i studimit. 2. Për të marrë informacionin e nevojshëm mbi përmbajtjen e programit të studimit në website lançohet çdo informacion apo thirrje mbi leksione të hapura, aktivitete të tjera. 3. Përtej website zyrtar https://uamd.edu.al në faqen e Facebook, Instagrami dhe LinkedIn institucionin publikon foto nga çdo aktivitet, thirrje për aktivitete dhe çdo informacion të mundshëm. Përtej faqeve zyrtare të institucionit, vetë FTI ka faqen e saj në Facebook ku publikojnë çdo informacion, aktivitet apo thirrje specifike për programin e studimit.⁹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Raportet financiare të UAMD nuk realizohen në rang programi studimi. Raportet financiare realizohen në rang njësie kryesore ose institucional duke diversifikuar shpërndarjen e kostove dhe të ardhurave midis programeve të studimit që ofron UAMD. Mbështetja e UAMD për programin e studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” është kryesisht për pagat e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, personelit ndihmës-akademik në shërbim të këtij programi studimi dhe për mirëmbajtjen e ambjenteve në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve. Bizneset partnere dhe projektet kombëtare dhe ndërkombëtare mbështesin me investimet në paisjet laboratorike, pagesat e trajnuesve të huaj (dieta, udhëtim, qëndrim), pagesat e konsulentëve të huaj dhe sponsorizime në aktivitete të ndryshme të organizuara në funksion të studentëve të FTI. Një tjetër mbështetje është edhe ofrimi i bursave për një pjesë të studentëve si dhe shpenzimet për bibliotekën. Pavarësisht diversifikimit të të ardhurave brenda programeve të studimit në UAMD, vlen të theksohet se program i studimit Bachelor në “Multimedia dhe Televizion Dixhital” është një ndër programet me numrin më konstant të studentëve të regjistruar për çdo vit akademik.
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të	

⁸ <https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/#>

⁹ <https://www.facebook.com/FTIUAMD>

realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.				
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Personeli akademik me kohë të plotë i DTI / FTI ka lidhur një kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë asistent lektor dhe me afat të pacaktuar për kategoritë lektor dhe profesor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Edhe në rastet e kontratave me kohë të caktuar, rinovimi i tyre bëhet automatikisht bazuar në rekomandimin e përgjegjësit të DTI dhe dekanit të FTI në rastet kur performanca e personelit akademik është në nivelin e kërkuar. UAMD siguron mbulimin me korrektësi të të gjitha detyrimeve financiare duke përfshirë edhe mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.			
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD dërgojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat. Koordinimi i propozimeve të njësisë kryesore realizohet fillimisht nga Senati Akademik i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe harton planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit.			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në legjislacionin në fuqi, përcaktimi i kriterëve pranuese të programin Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për këtë program studimi (DTI, FTI, Rektorat, Senat Akademik, MAS) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të UAMD si dhe në portalin U-Albania për të gjithë maturantët. Bazuar në udhëzimet dhe periudhat e përcaktuara nga MAS realizohet edhe shpallja e

Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	fituesve si dhe regjistrimi i tyre me dokumentacionin e kërkuar dhe brenda afateve të përcaktuara në këtë udhëzim. Për transparencë i gjithë ky proces aplikohet në sistemin U-Albania ku çdo aplikant mund të informohet për rezultatin dhe ecurinë e aplikimit të tyre. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UAMD (<i>Evidencë 31. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studenteve</i>) duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët. Gjatë këtij procesi aplikantët kanë edhe mundësinë e ankimimit por deri më sot për programet e studimit të FTI asnjëherë nuk ka pasur raste të tilla.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Çdo fillim viti akademik, DTI propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital. Këto kriteret pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e DTI dhe FTI. (<i>Evidencë 3. Rregullore FTI, neni 29; Evidenca 32. Vendim Senati për Kuotat</i>). Këto kriteret, si të gjitha vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Gjithashtu njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet publikohen edhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD dhe FTI. ¹⁰
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Përveç publikimeve në faqen elektronike zyrtare të UAMD dhe në rrjete sociale, këto kriteret janë të publikuara edhe në portalin U-Albania ku çdo maturant mund ta aksesojë lehtësisht. Përsa i përket procedurave të transferimit të krediteve, ato janë të përcaktuara qartë në rregulloret e institucionit. (<i>Evidencë 3. Rregullore FTI, neni 38 dhe neni 39</i>).
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Për çdo vit akademik, për kuotat e programit Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital parashikohen kuota të synuara për kandidatë të kategorive të veçanta si dhe kandidatët e trojeve dhe shtetasit e huaj. (<i>Evidencë 32. Vendim Senati për Kuotat</i>)
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	UAMD aplikon politikat shtetërore për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. Aktualisht në programet e studimit të ofruara nga FTI janë 82 studentë që përftojnë bursa nga këto politika.

¹⁰ <https://www.facebook.com/FTIUAMD/> dhe <https://www.facebook.com/uamdoofficial/>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Koordinatori i programit Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital si dhe drejtuesit e DTI dhe FTI organizojnë takime periodike me studentët e këtij programi për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për ti informuar për çdo kërkesë dhe afat që ndikon në përparimin e tyre akademik. Studentët njihen me procedurat e vlerësimit të dijeve që në javën e parë të mësimi (ditë informuese për studentët e vitit të parë) si dhe informohen nga personeli akademik gjatë orës së parë të çdo lënde që ata frekuentojnë. Për të kaluar një lëndë studentit duhet të marrë 505 pikë në provime (metoda e vlerësimit me notë dhe pikë janë publike dhe të qarta në syllabus). Ndërkohë ka sezone ekstra (Sezoni i dimrit, Sezoni i verës dhe sezoni i vjeshtës) për të ndihmuar studentët dhe në rast se studentit nuk plotëson kohën e duhur brenda të cilit duhet të përfundojë studimet atëherë institucioni ka të drejtë përjashtimin e studentit nga programi i studimit. <i>(Evidenca 2. Rregullore UAMD Kreu III Organizimi i Studimeve)</i> Gjatë javës së orientimit studentët informohen edhe për procedurat që duhet të ndjekin për detyrimet përmbyllëse. Informimi i studentëve për të gjithë informacionin e mësipërm realizohet me komunikim të drejtpërdrejt në auditor duke sqaruar çdo paqartësi që studentët mund të kenë.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.				
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.				
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e FTI. <i>(Evidencë 3-Rregullore FTI, neni 38 dhe neni 39).</i> Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme.			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	FTI në mënyrë periodike organizon edhe ditë orientuese për maturantët. Këto takime organizohen si: - ditë të hapura informimi ku maturantët mund të vizitojnë ambientet universitare të FTI, - Takime informuese në gjimnaze për maturantët - Takime informuese të organizuara në rang rajonal dhe kombëtar nga ana e MAS ose Drejtorive Arsimore Rajonale - Takime informuese online me grupe maturanësh në rang gjimnazesh			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Çdo student në momentin e regjistrimit në programin Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital merr nga sekretaria mësimore kurrikulën e programit të studimit ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje). Për më tepër, lektorët lëndëve përkatëse udhëzojnë dhe informojnë studentët përgjatë orëve të mësimit sa herë që kanë nevojë për sqarime mbi vjushmërinë e studimeve.			
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo lënde studentët marrin nga personeli akademik i kursit programin e lëndës ku përcaktohen qartë temat dhe shpërndarja e tyre përgjatë semestrit, periudha e provimeve, objektivat formues, mënyra e vlerësimit etj.			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Përgjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve studentët janë në kontakt të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e biznesit. Këta të fundit zhvillojnë në mënyrë periodike trajnime ose testime për identifikimin e studentëve me potencial për punësim si dhe informojnë vazhdimisht studentët për kërkesat e tregut të punës dhe për mundësitë e punësimit të tyre në përfundim të programit të studimit dhe në disa raste edhe gjatë kohëzgjatjes së programit të studimit.			
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Gjatë javës së orientimit për studentët e vitit të parë (java e parë e mësimit), studentët informohen edhe për ambientet dhe infrastrukturën e FTI që është në dispozicion të studentëve përgjatë kohëzgjatjes së studimeve të tyre. Përsa i përket ambienteve mësimore, informacioni për ambientet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në sistemin Pitagora.			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Informacioni në lidhje me programin e studimit u ofrohet studentëve personalisht me komunikim të drejtpërdrejtë nga sekretaria mësimore. Gjithashtu ky informacion është i aksesueshëm edhe në distancë pasi është i publikuar në faqen elektronike zyrtare të UAMD si dhe në sistemin Pitagora.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Të gjitha statistikat (me përjashtim të të dhënave të punësimit) disponohen nga sekretaria mësimore e FTI-së e cila i përcjell ato te drejtuesit e DTI dhe FTI dhe në zyrën e ALUMNI. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik (regjistrat themeltar) ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora. Programi i studimit bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital është programi bachelor me një numër të qendrueshëm studentesh dhe regjistrimesh në rang fakulteti. (<i>Evidence 30. Të dhënat për studentët MTVD</i>). Përsa i përket gjurmimit të studentëve pas diplomimit të tyre është përgjegjësi e ALUMNI.			
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore menaxhohen kryesisht nga sekretaria mësimore e FTI, koordinatori i programit të studimit dhe drejtuesit e FTI. Informimi i drejtuesve të FTI dhe i personave të autorizuar realizohet me anë të komunikimit zyrtar të brendshëm të UAMD. Këto statistika mund të përftohen edhe nga sistemi Pitagora. Edhe në këtë rast shkëmbimi i të dhënave realizohet me anë të komunikimit zyrtar midis drejtuesve të FTI dhe RASH.			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Në mënyrë periodike, UAMD kontrollon mbarëvajtjen e punës si dhe zbatimin me korrektësi të detyrave dhe kërkesave ligjore për menaxhimin e të dhënave të studentëve. Këto kontrole mund të organizohen në nivel njësie kryesore, në nivel institucional dhe në disa raste si audit i jashtëm nga MAS.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në çdo organ vendimmarrës në UAMD në raporte sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtare me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si NJBSC, Këshillin e Etikës etj.			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	FTI merr opinionin e studentëve në përfundim të çdo lënde si dhe ruan kontakte me studentët edhe pas diplomimit të tyre. Ndryshimi i kurrikulave si rregull për FTI realizohet në mënyrë periodike çdo 5-6 vite. Megjithatë opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve etj. Ndryshimet afatshkurtër në programin e studimit mund të reflektohen në programet e lëndëve.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	FTI ka një mënyrë plotësisht transparente dhe të unifikuar të vlerësimit dhe të ballafaqimit të rezultateve. Personeli akademik ka detyrim të ballafaqojë rezultatet me studentët 72 orë nga realizimi i testimit dhe të sqarojë çdo paqartësi të tyre në lidhje me vlerësimin e testimit. <i>(Evidencë 3. Rregullore FTI, neni 53, pika 7)</i> Në rast se edhe pas ballafaqimit të rezultateve studenti nuk është i bindur për vlerësimin, ai ka të drejtë të kërkojë rishikimin e tezës jo më vonë se 48 orë nga marja e rezultateve. <i>(Evidencë 3. Rregullore FTI, neni 56, pika 1)</i> Rishikimi i tezës realizohet nga një komision i ngritur nga njësia bazë që mbulon lëndën në prezencë të studentit dhe personelit akademik të kursit. Komisioni vendos për vlerësimin përfundimtar. <i>(Evidencë 3. Rregullore FTI, neni 56, pika 6)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Njësia përgjegjëse për informimin e studentëve në UAMD është Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës. Sektori i Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë. <i>(Evidencë 34 - Rregullore e sektorit të komunikimit, Alumnit dhe karrierës)</i> Përsa i përket programit bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital, informimi i studentëve për mundësitë e punësimit, trajnimet dhe kontaktet me studentët e diplomuar realizohen direkt nga FTI ku një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i ngushtë me bizneset. Personeli akademik i FTI dhe njësitë bazë raportojnë te drejtuesit e FTI në lidhje me organizimin e aktiviteteve informuese dhe merr miratimin e tyre për realizimin e këtyre aktiviteteve.			
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.				
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.				
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. (<i>Evidencë 39. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim</i>) Kjo njësi organizon gjatë vitit akademik trajnime për personelin akademik në lidhje me metodat innovative në mësimdhënie si dhe për rritjen e aftësive pedagogjike të personelit akademik.			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Monitorimi dhe vlerësimi i aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik realizohet kryesisht bazuar në anketimet periodike të studentëve çdo fund semestri mësimor. (<i>Evidencë 2. Rregullore UAMD, neni 115, pika dh</i>) Në këto anketime studentët shprehin opinionin e tyre në lidhje me cilësinë e mësimdhënies për personelin akademik dhe lëndët e frekuentuara në atë semestër mësimor. (<i>Evidencë 41. Formular vlerësimi nga studentet</i>)			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelin akademik, përgjegjësit e njësive bazë analizojnë rezultatet e ankimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Një tjetër pyetësor që angazhon studentët është anketimi gjithëpërfshirës vjetor në lidhje me opinionin e tyre të përgjithshëm për eksperiencën e tyre gjatë kohëzgjatjes së studimeve. Rezultatet e këtij anketimi bëhen publike nga NJBSC në faqen elektronike zyrtare të UAMD. (<i>Evidencë 25. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)</i>)			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në zbatim të nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohet se njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave dhe Standarteve të Cilësisë. Misioni i kësaj Drejtorie / NJBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim. <i>(Evidencë 36. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 8)</i> NJBSC është ngritur edhe në nivel fakulteti për FTI. <i>(Evidencë 37. Urdhër Koordinatore dhe NJSBC)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NJBSC në nivel institucional kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel institucional. <i>(Evidencë 2 - Rregullore UAMD, Neni 20, pika 5)</i> NJBSC e FTI kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë në nivel fakulteti kur kjo kërkohet nga drejtuesit e FTI ose nga rregulloret institucionale. Kjo njësi monitoron dhe vlerëson proceset e sigurimit të cilësisë bazuar në manualët dhe treguesit e hartuar nga NJBSC institucionale. NJBSC monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm dhe raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj. <i>(Evidencë 36. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 9)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në pjesën gjashtë të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. <i>(Evidencë 36 - Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 17 dhe neni 19)</i> UAMD ju nënshtrua procesit të riakreditimit Institucional dhe u vlerësua pozitivisht me një Akreditim për 4 vite deri në Mars 2026.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime	Si pjesë e raportit vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë është edhe monitorimi i mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit shkencor. <i>(Evidencë 38. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë, fusha 4)</i> Ky vlerësim trajton si treguesit sasior ashtu edhe treguesit cilësor të aktivitetit të personelit akademik, njësisive bazë / kryesore si dhe të programeve të studimit që ato ofrojnë.

nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Njësitë përgjegjëse për monitorimin dhe rishikimin e kurrikulës së programit Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital janë DTI, FTI dhe Senati Akademik. <i>(Evidencë 40. Riorganizimi i programit Bachelor në MTVD)</i> UAMD përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit bachelor në Multimedia dhe Televizion Digjital realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit dhe nga njësitë e mësipërme. Çdo fillim viti akademik asambleja e personelit akademik të DTI diskuton në lidhje me programet e studimit që mbulon duke përfshirë edhe programin bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital. Në rastet kur shikohet e arsyeshme DTI propozon / miraton ndryshimet e nevojshme duke dokumentuar formalisht ndryshimet e bëra dhe arsyetimet përkatëse. Vlerësimi i mbarëvajtjes së programit bachelor në Multimedia dhe Televizion Digjital bazohet në disa parametra sasior dhe cilësor të cilët vijnë kryesisht nga statistikat e ofruara nga sekretaria mësimore e FTI dhe anketimet e studentëve. Disa nga parametrat që përdoren për vlerësimin e programit të studimit janë cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit, opinioni i studentëve për lëndë të veçanta dhe për programin e studimit në përgjithësi etj. Këto të dhëna organizohen nga koordinatori i programit të studimit dhe u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të FTI. Bazuar në këto të dhëna përcaktohen edhe objektivat e programit të studimit për vitin pasardhës akademik.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,	Vlerësimi i cilësisë së programit bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital sigurohet nëpërmjet: - cilësisë dhe numrit të personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie për këtë program - cilësisë së materialeve mësimore dhe plotësuese - infrastrukturës mësimore - ndërkombëtarizimit

testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndër-institucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Për vlerësimin e programit Bachelor në Multimedia dhe Televizion Dixhital përdoren të dhënat e ofruara nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinioni i studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie, opinioni i përfaqësuesve të biznesit, anketimi i studentëve të diplomuar etj.			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Vlerësimet e bazuara në monitorimin e aktivitetit mësimor realizohet si nga NJBSC e UAMD ashtu edhe nga ajo e FTI. <i>(Evidencë 36 - Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, neni 6)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni përfshin të gjitha palëve e interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit. Kodi i Etikës, Rregullore e UAMD, Statuti i UAMD, Rregullore e NJSBC. Vlerësimi i Performacës së stafit nga drejtuesi i NJBTI Institucioni nxit dhe siguron rritjen cilësisë në të gjitha nivelet. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: - Senati Akademik - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC) Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakulteteve (NJBSC Fakulteti) - Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për çdo program (GVB.Bch. /GVB.MP. /GVB.Msc.) - Koordinatorët e Programeve (Ko.Bch. / Ko.MP / Ko.Msc.)

	<i>(Evidenca 36. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, neni 2)</i>			
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka të mirë përcaktuara rolet dhe detyrat për stafin akademik, administrative, studentët, stafit ndihmës-akademik dhe ndihmës-administrativ. <i>(Evidencë 14. Struktura Organizative e UAMD)</i> Njësia kryesore dhe bazë ka hartuar rregulloret përkatëse me përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për stafin akademik, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit. <i>(Evidenca 3- Rregullore e FTI; Evidenca 10 - Rregullore e programit të studimit Bachelor në MTVD)</i>			
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	I gjithë stafi akademik i njësisë bazë dhe njësisë kryesore sigurojnë mësimdhënie cilësore, aktivitete kërkimore-shkencore dhe nxisin rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet drejtuese akademike. Stafi administrativ dhe ai akademik janë në bashkërendim të plotë të menaxhimit dhe harmonizojnë detyrat në arritjen e cilësisë. NJKTI është njësia kryesore më e re e UAMD dhe punon gjithnjë e më shumë për përmirësimin e të gjitha mekanizmave që përdoren për cilësinë.			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në punën e përditshme, stafi administrativ dhe si akademik respekton integritetin akademik dhe kujdeset për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. <i>(Evidenca 4- Kodi i Etikës UAMD)</i> Gjithashtu, stafi akademik diskuton dhe trajton problematika që lidhen me veprimtaritë akademike.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Hartimi i kurrikulave bashkëkohore dhe syllabuseve të programit të studimit Bachelor në MTVD është bërë nga lektorët e DTI të ku një pjesë e tyre kanë studiuar dhe kanë ekspertizë në universitete të huaja. Gjithashtu, kurrikula e programit të studimit ka kaluar procedura vlerësimi nga ekspertë të fushës nga universitete të BE. Është hartuar mbi bazën e mendimeve, sugjerimeve dhe ekspertizës së specialistëve ndërkombëtarë. ¹¹			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

¹¹ <https://dimtv-project.al/external-evaluation-of-bachelor-and-pm-study-programs-by-eu-experts/>

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni ka ndërtuar rregullore të posaçme për SBC e institucionit duke përfshirë dhe analizat mbi programin e studimit. Institucioni funksionon sipas Statutit, Rregullores dhe bazës përkatëse ligjore në vend. ¹² Në websiten e institucionit uamd.edu.al, në rrjetet sociale të institucionit si dhe në faqen e facebook-ut për FTI ¹³ janë pasqyruar të gjitha informacionet e nevojshme për veprimtarinë.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni sipas rregullores dhe kodit të etikës publikon rezultatet dhe analizat e rezultateve të vlerësimit të programit të studimit duke respektuar etikën akademike dhe privatësinë e palëve të përfshira. Rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësve të departamentit, si dhe dekanëve përkatës. (Evidenca 4 - Kodi i Etikës UAMD Neni 7; Evidenca 36 - Rregullore e sistemit të brendshëm të cilësisë (NJSBC), Neni 6).
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në rast nevojë, me qëllim përmirësimin e mangësive dhe dobësive të evidentuara, rezultatet e vlerësimeve shoqërohen me një plan masash. Në rastet kur evidentohen rezultate nën nivelin mesatar për lektorët me kohë të pjesshme, në vitin akademik pasardhës kontrata e tij nuk rinovohet. Në rastet kur evidentohen rezultate jo të kënaqshme për lektorët me kohë të plotë, Drejtuesit të NjBTI-së i lind e drejta për të dhënë vërejtje. (Evidenca 3 - Rregullore e FTI, Neni 85) (Evidenca 2- Rregullore e UAMD, Neni 113)
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Njësitë përgjegjëse të UAMD analizojnë dhe raportojnë periodikisht të gjithë të dhënat e marra nëpërmjet pyetësorëve të hartuar për studentët, stafit administrativ dhe akademik, si edhe për të gjithë veprimtaritë që ata zhvillojnë. Gjithashtu edhe njësitë bazë ndërmerr hapat e nevojshme për të marrë opinionin dhe mendimin e studentëve për sa i përket cilësisë së mësimdhënies. (Evidencë 38- Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.).

¹² <https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/programi-i-transparences/>

¹³ <https://www.facebook.com/FTIUAMD>

Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Koordinatori i programit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në UAMD dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve në universitet. Detyrat e koordinorit të programit janë si më poshtë: 1. Raporton pranë dekanit dhe NjBSC-së mbi cilësinë dhe standardet e programit që mbikëqyr. 2. Përgatit raporte vjetore, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi programin që mbikëqyr, duke u bazuar në formatet e përcaktuara nga NjBSC-ja. 3. Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin që mbikëqyr. 4. Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e programit që mbikëqyr. 5. Në bashkëpunim me koordinatorin e departamentit për kërkimin shkencor, përgatit një raport vjetor, dhe kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi, mbi veprimtarinë kërkimore-shkencore duke vlerësuar : a) Numrin e publikimeve në pesë vitet e fundit të stafit akademik të angazhuar në departamentin ofrues të programit. b) Numrin e citimeve nga autorët e huaj (duke u bazuar në databazat e citimeve dhe faktorit të impaktit) të artikujve të publikuar nga stafi akademik në departamentin ofrues të programit. c) Numrin e projekteve të propozuara dhe realizuara nga departamenti dhe/ose stafi përbërës i tij. Numrin e konferencave dhe aktiviteteve shkencore të organizuara nga departamenti dhe/ose fakulteti, që kanë në fokus tematikat e programit të ofruar. <i>(Evidenca 10- Rregullore e programit të studimit (Bachelor në MTVD), Neni 10; Evidenca 36 – Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, Neni 10)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

48



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Multimedia dhe Televizion Dixhital"

RVB dhe analiza e standardeve të tij do të mbyllet me "Analizën përmbledhëse të RVB" sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësitë, Threats-pengesat). Njësia kryesore e Teknologjisë së Informacionit është një ndër fakultetet më të reja në UAMD dhe synon të jetë një ndër njësitë përbërëse më elitare si pasojë e burimeve njerëzore që ka dhe fushave bashkëkohore të kërkimit shkencor në teknologji.

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Program studimi unik në Shqipëri dhe plotëson dijet teorike të marra gjatë ciklit të parë të studimeve Bachelor;
2. Ideim, organizim dhe administrim i programit në përputhje me standardet europiane.
3. Programi i studimit dhe syllabuset e kurseve të përfshira në kurrikul plotësojnë standartet e kërkuara gjë që tregohet në metodologjinë e mësimdhënies, informacionin dhe literaturën bashkëkohore të përdorur;
4. Bashkëpunime me institucionet arsimore europiane me eksperiencë në fushën e multimedias
5. Përmirësimi i kurrikulës në mënyrë të vazhduar për të ecur në kohorencë me zhvillimet e fundit teknologjike në multimedia.
6. Mbështetja dhe ngritja e programit në përputhje me strategjinë e zhvillimit, misionit dhe vizionit të UAMD dhe Njësia kryesore të Teknologjisë së Informacionit si pjesë e tij;
7. Infrastrukturë moderne e vënë në dispozicion të stafit dhe studentëve;
8. Menaxhimi efektiv i programit përmes ndarjes së ngarkesës mësimore, cilësisë së mësimdhënies, vlerësimit të studentëve dhe pedagogëve, realizimi i projekteve praktike, etj;
9. Vitaliteti i stafit akademik, profesionalizmi, mësimdhënia cilësore dhe interaktive siguron përmbushjen e objektivave të këtij programi studimi;
10. Klima pozitive e bashkëpunimit midis stafit akademik dhe studentëve ku respektimi i të drejtave të tyre është në qendër të politikave dhe strategjive të zhvillimit;
11. Përkushtim i Njësia bazëit për të ofruar një program serioz dhe konkurrues;
12. Fushat dhe specialitetet e programit të studimit së bashku me infrastrukturën moderne, hapin rrugën për ndërtimin e një infrastrukturate të duhur për qëllime kërkimore në institucion dhe më tej duke u bërë ndër të parët e specializuar në këtë fushë.
13. Personeli akademik, i trajnuar nga partnerët europianë, do të mundësojë rritjen e cilësisë së programit MP në MTVD dhe do të mundësojë staf akademik të dedikuar për këtë program studimi;
14. Aplikimi i multimedias, si mjet teknologjik, në fushën e mësimdhënies duke rritur cilësinë dhe nivelin e të nxënit;
15. Rritja e bashkëpunimi me universitetet e tjera të huaja dhe të vendit;
16. Rritja e bashkëpunimit të mëtejshëm me biznesin dhe ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta;

Pika të dobëta:

- Numër i vogël studentësh të regjistruar
- Përfshirja e kufizuar e studentëve në veprimtaritë kërkimore të njësia bazë në fushën e multimedias;
- Mungesa e stafit akademik me grada shkencore dhe specializime në fushën e multimedias jo vetëm në UAMD por dhe në Shqipëri dhe në Rajon;
- Multimedia dhe Televizion Dixhital është një program i ri, i ofruar vetëm në disa universitete publike dhe private nga pikëpamja artistike, dhe si një degë e re, studentët hezitojnë në zgjedhjen e saj, duke aplikuar në degë tradicionalisht të njohura;
- Mungesa e literaturës (hardcopy) specifike për fushën e multimedias në bibliotekën e universitetit

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Lista e dokumenteve bazë për procesin e akreditimit të programeve të studimit

Lista e mëposhtme është dokumentacioni i detyrueshëm që institucionet duhet të dorëzojnë së bashku me RVB në kuadër të akreditimit të programeve të studimit. Nuk është e thënë që çdo pikë e mëposhtme duhet të jetë një dokument i veçantë, por në një dokument mund të përmbledhen disa nga të dhënat e kërkuara. Në rastin e programeve të ciklit të dytë (Master i Shkencave) dhe të ciklit të tretë (Specializim Afatgjatë dhe Doktoratë) i gjithë ky dokumentacion duhet të jetë në gjuhën shqip dhe angleze ashtu si dhe RVB. Në cdo rast bazohuni në Manualin për *“Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit”*

Evidenca 1. Statuti i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

Evidenca 2. Rregullore e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

Evidenca 3. Rregullore e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit

Evidenca 4. Kodi i etikës UAMD

Evidenca 5. Urdhër për ngritjen e grupeve të RVB për akreditim

Evidenca 6. Vendimi i hapjes së programit të studimit Bachelor në MTVD

Evidenca 7. Kurrikula Bachelor në MTVD

Evidenca 8. Plani mësimor Bachelor në MTVD

Evidenca 9. Syllabuset e programit të studimit Bachelor në MTVD

Evidenca 10. Rregullore e programit të studimit Bachelor në MTVD (MTVD)

Evidenca 11. Misioni dhe studimi i tregut të punës për programin Bachelor në MTVD

Evidenca 12. Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025

Evidenca 13. Diploma dhe suplementi i diplomës

Evidenca 14. Struktura Organizative e UAMD

Evidenca 15. Struktura e programeve të studimit

Evidenca 16. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Juridike (DBNjJ)

Evidenca 17. Kodifikimi i Programeve të Studimit UAMD

Evidenca 18. Laboratorët e FTI

Evidenca 19. Personeli akademik në FTI

Evidenca 20. Personeli akademik i angazhuar në MTVD

47

- Evidenca 21.** CV e stafit akademik të MTVD
- Evidenca 22.** CV e stafit ndihmës akademik MTVD
- Evidenca 23.** Formular vlerësimi nga studentët
- Evidenca 24.** Analiza Vjetore DTI
- Evidenca 25.** Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ)
- Evidenca 26.** Forume, Seminare dhe Workshop-e akademike të organizuara në UAMD
- Evidenca 27.** Model Kontrate Pune – UAMD
- Evidenca 28.** Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Evidenca 29.** Marrëveshjet e Bashkëpunimit
- Evidenca 30.** Të dhënat për studentët MTVD
- Evidenca 31.** Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studentëve
- Evidenca 32.** Vendim Senati për Kuotat
- Evidenca 33.** Workshop-e Studentore (FTI)
- Evidenca 34.** Rregullore e sektorit të komunikimit, Alumnit dhe karrierës
- Evidenca 35.** Rregullorja e bibliotekës
- Evidenca 36.** Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë
- Evidenca 37.** Urdhër Koordinatorët dhe NJSBC
- Evidenca 38.** Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë.
- Evidenca 39.** Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim
- Evidenca 40.** Riorganizimi_i_programit Bachelor MTVD
- Evidencë 41.** Formular vlerësimi nga studentët



48

Handwritten signatures and initials in blue ink, including a large signature on the left, a signature in the center, and several initials on the right.